



AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
Kosovo Academy For Public Safety/ Kosovska Akademija za Javnu
Bezbednost

FAKULTETI I SIGURISË PUBLIKE

Manuali për provim pranues

Vushtrri, 2016

PËRMBAJTJA E MANUALIT

1. Hyrje mbi manualin	3
2. Informata të përgjithshme mbi provimin (llojet e pyetjeve, koha e nevojshme)	3
3. Pjesa e I-rë - Njohuri të përgjithshme nga shkencat shoqërore...	3
3.1. Pyetje orientuese	3
3.2. Literatura	8
3.3. Ese	8
4. Pjesa e II-të - Njohuri nga fusha e drejtësisë	9
4.1 Njohuri nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës	9
4.2. Pyetje orientuese	9
4.3. Literatura	11
4.4. Njohuri nga Lënda: Fillet e së Drejtës	11
4.5. Pyetje orientuese	11
4.6. Literatura	13
5. Pjesa e III-të - Njohuri logjike	13

1. Hyrje mbi manualin

Manuali për përgatitjen e provimit pranues në Fakultetin e Sigurisë Publike, është hartuar me qëllim që kandidatët të orientohen rreth natyrës së provimit pranues, pyetjeve orientuese, kohëzgjatjes së provimit, dhe literaturës së përdorur.

Manuali përbëhet prej tri pjesëve, siç janë: Pjesa e I-rë - Njohuri të përgjithshme nga shkencat shoqërore; Pjesa e II-të - Njohuri nga fusha e drejtësisë; si dhe Pjesa e III-të - Njohuri logjike. Secila pjesë përfshin përshkrimin narrativ, pyetjet orientuese dhe literatura referuese. Në secilin pjesë paraqiten objektivat që duhet arritur kandidatët me rastin e nënshtrimit në provimin pranues.

Manuali në tërësi përmban 200 pyetje orientuese, prej të cilave do të përzgjidhen 30 pyetje për testin në provimin pranues. Përveç esesë, manuali do të përmbajë edhe pyetjet nga gjuha angleze, në të cilat do të kërkohet zgjidhje gramatikore, drejtshkrimi në gjuhën angleze si dhe përkthimi i një paragrafi të caktuar.

2. Informata të përgjithshme mbi provimin (llojet e pyetjeve, kohëzgjatja)

Testi i provimit pranues do të përmbajë 30 pyetje. Pyetjet do të jenë të formës së hapur, të strukturuar dhe një ese. Pyetjet dhe eseja ndërlidhen me fushën e programit të studimit sigurisë publike në Fakultetin e Sigurisë Publike. Kohëzgjatja e provimit pranues do të jetë 60 minuta. Kandidatët janë të obliguar që plotësimin e testit ta bëjnë me stilolaps me ngjyrë të kaltër. Në provimin pranues komunikimi i kandidatëve në mes vete është i ndaluar. Ata që kopjojnë humbin të drejtën e provimit pranues.

3. Pjesa e I-rë - Njohuri të përgjithshme nga shkencat shoqërore

Në këtë pjesë, paraqiten pyetjet orientuese nga fusha e shkencave shoqërore. Përmes kësaj pjesë kandidatët do të përgatiten me përkufizimet e konceptit të shtetit, shoqërisë, sigurisë, forcave të rendit, sigurisë së brendshme dhe çështjeve politike, rolin dhe fushëveprimin e sektorit publik, krahasimi i sistemeve të sigurisë në Evropë, njohuri për sigurinë në Kosovë. Objektivat e pjesës së I-rë, janë:

Përcaktimi i formave të sigurisë publike, të njihen me mekanizmat e mirëqenies socioekonomike, të zhvillojë njohuri rreth koncepteve të shoqërisë, sigurisë dhe fenomeneve tjera shoqërore. Të analizojë modelet e ndryshme të sistemit të sigurisë dhe efektet e mirëqenies lidhur me sigurinë në komunitet.

3.1 Pyetje orientuese

- 1) Çka nënkuptohet me nocionin Referendum?
- 2) Çka nënkuptohet me Administratë Publike?
- 3) Çfarë nënkuptohet me nocionin Demokraci?
- 4) Çfarë është Shërbimi Informativë?

- 5) Çfarë nënkuptohet me nocionin Terrorizëm?
- 6) Çka nënkuptohet me Gjenocid?
- 7) Çfarë nënkuptohet me Siguri Publike?
- 8) Çka nënkuptojmë me Bashkim Evropian?
- 9) Cili është roli i NATO-së?
- 10) Cili është roli i OKB-së?
- 11) Çka quajmë shtet ligjor?
- 12) Çka nënkuptojmë me nocionin klasë?
- 13) Çka quajmë ideologji?
- 14) Ç'është opinionimi publik?
- 15) Çka nënkuptojmë me termin bandë?
- 16) Ç'është burokracia?
- 17) Ç'është Demokracia?
- 18) Çka nënkuptojmë me dhunë në familje? 19) Çka nënkuptojmë me elitë të pushtetit? 20) Çka nënkuptojmë me fundamentalizëm? 21) Çka nënkuptojmë me revoltë?
- 22) Kur kemi të bëjmë me situatë kritike?
- 23) Ç'është sovraniteti?
- 24) Ç'është turmë e përqendruar?
- 25) Çka nënkuptojmë me lëvizje sociale?
- 26) Çka kuptojmë me termin racë?
- 27) Ç'është personalitet autoritar?
- 28) Çfarë është siguria?
- 29) A përbën trafiku i drogës një problem kombëtar sigurie?
- 30) A duhet të shihet dhe trajtohet si çështje sigurie emigracioni i jashtëligjshëm? 31) Cilit do t'i jepnit përparësi: kërkimit të paqes apo kërkimit të drejtësisë?
- 32) Ku ndryshon lufta nga format tjera të dhunës?
- 33) Ç'konsiderata duhet të kenë parasysh vendimmarrësit, kur mendojnë për përdorimin e forcës?
- 34) A janë përjashtimet në ndalimin e përdorimit të forcës, si vetëmbrojtja paraprake të justifikueshme?
- 35) A duhet që ndalimi i përdorimit të forcës të jetë pjesë e ekzistencës së një mekanizmi efektiv, me anë të cilit mund të garantohet siguria e shteteve?
- 36) A e kanë ndryshuar natyrën e terrorizmit feja, kultura dhe teknologjia?
- 37) Cila është lidhja ndërmjet globalizmit dhe shtimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit?
- 38) Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet më të mëdha ndërmjet organizatave kriminale dhe terroriste?
- 39) Cilat janë institucionet përgjegjëse vendore të sistemit të sigurisë nacionale në Kosovë?

- 40) Si funksionon sistemi i Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë?
- 41) Çfarë përfshinë kuadri ligjor i rregullimit të sistemit të sigurisë së një shteti?
- 42) Cili institucion është përgjegjës për të mbledh informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës?
- 43) Cilat janë funksionet themelore të policisë në një shoqëri demokratike të sunduar nga forca e ligjit?
- 44) Pse siguria në komunikacion vazhdon të jetë një ndër sfidat më të pa adresuara në Kosovë?
- 45) Si realizohet mbikëqyrja demokratike e institucioneve të sigurisë: institucionet dhe aktorët e ndryshëm?
- 46) Çka paraqet sistemi parlamentar, presidencial dhe i përzier?
- 47) Çfarë forme të qeverisjes ka Kosova dhe si janë të ndara pushtetet? 48) Çka paraqet imuniteti?
- 49) Si rregullon Kushtetuta e Kosovës gjendjen e jashtëzakonshme? 50) Çka është paraburgimi dhe sa mund të zgjatë?
- 51) Si e kupton fjalën “krim”?
- 52) Çka është delikuenca?
- 53) Si kuptohen krimet jakë-bardha?
- 54) Kur u krijua policia e parë e uniformuar?
- 55) Në cilin vend u krijua policia e parë moderne në botë? 56) Çka është zingjiri komandues?
- 57) Cilat janë karakteristikat e sjelljeve deviante? 58) Roli i forcave të rendit është?
- 59) Cyber-krimi ka të bëjë me së shumti me: vjedhjet, rrëmbimet apo krimet përmes teknologjisë informative?
- 60) Çka paraqet bilanci i gjendjes?
- 61) Çka paraqet një detyrim financiar?
- 62) Sa pika doganore janë në Kosovë?
- 63) Çka kuptoni me fenomenin “shpëlarje e parasë”? 64) Çka paraqet liberalizimi i tregut?
- 65) Sa vende anëtare ka Bashkimi Evropian? 66) Cili është roli i Komisionit Evropian?
- 67) Në cilin shtet të BE-së është selia e Bashkimit Evropian? 68) Në cilin shtet të BE-së është selia e Parlamentit Evropian? 69) Çka paraqet inflacioni?
- 70) Çka paraqet deflacioni?
- 71) Çka nënkuptojmë me policin në komunitet? 72) Cili është roli i policisë?
- 73) Çka nënkuptojmë me termin viktimë?

- 74) Çka paraqet reketizmi?
75) Çka paraqet për ju kriminaliteti politik apo deliktet politike?
76) Cilët janë faktorët që ndikojnë në paraqitjen e krimeve në trafik? 77)
Përshkruani se çka kuptoni me recedivizm?
78) Çka kuptoni me incest?
79) Çka nënkuptoni me termin Pedofilia?
80) Çka nënkuptoni me shoqëri civile?

Pyetjet nga Gjuha Angleze

- 81) Fill in blanks (use just one of the words from brackets)
John with his friends are going to a trip together, however, John(is/are) not feeling well.
John (Doesn't /don't) know much about the city.
If I (was/were) here, I (Would have/ will have) done many things.
Tommy is going to play, but he (need/needs) some exercises and training to do. John (forget/forgot) to do his homework last night, and today the teacher will (gave/give) him more homework.
- 83) Please form positive sentences in Simple Present
Jehona/ the window/open
It/a lot/rain
Tom/with Amy/stay
He/ wash/ the car
I/American/be
- 84) Fill in blanks with appropriate forms of Past Simple Tense of the word “ be”.
It (be) cold yesterday.
We (be) late for the meeting.
The exam (be) difficult.
They (be) in Berlin.
That woman (not/be) Spanish.
- 85) Put in “few”, “a few”, “a little” or “little”
I have water left. There is enough to share. I have good friends. I am not lonely.
He has Education. He can't read or write and he can hardly count
She has self-confidence. She has a lot of trouble talking to new people.
There are Women politicians in the UK. Many people think there should be more.

86) Present Simple -make the present simple, choose positive, negative or question.

He/drive to work everyday

.....
I/not/think you're right

.....
We/have enough time?

.....
I/eat cereal in the morning

.....
You / watch a lot of TV

.....
He/not/read the newspaper

.....
She/dance often?

.....
Where/ I /come/ on Mondays?

.....
What/you/do at the weekend?

.....
You/not/drink much tea

87) Çka nënkuptojmë me borxhin publik?

88) Cili është roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës? 89)Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese?

90) Përkufizoni konceptet e stresit dhe të përshtatjes?

91) Ku qëndron dallimi në mes temperamentit dhe karakterit? 92)

Cilat janë disa nga strategjitë e zgjidhjes së problemit?

93) Shpjegoni ç'është varësia dhe toleranca e individit nga droga dhe ndaj tyre? 94) Cili është roli i avokatit të popullit?

95) Ç'është apartiedi?

96) Kur kemi të bëjmë me asimilim?

97) Çka nënkuptojmë me stratifikim shoqërorë? 98) Çka quajmë shtet ligjor?

99) Çka quajmë shtet diktatorial?

100) Çka nënkuptojmë me grupe të interesit?

3.2 Literatura

1. Anthony Giddens SOCIOLOGJIA, Fondacioni Soros 2003, Tiranë
2. Ragip Halili KRIMINOLOGJIA, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik 2002
3. Pajazit Nushi, Dashamir Bërxuli. PSIKOLOGJIA, Universiteti i Prishtinës
4. Prof.dr.Bejtush GASHI, Mr.sc.Bekim Avdijaj: “Roli dhe Përgjegjësitë e Policisë në Sistemin e Sigurisë së Brendshme në Kosovë”, Dukagjini, Pejë, 2012
5. Prof.dr.Bejtush GASHI, Mr.sc.Xhelal Jusufin: “Sistemi i Menaxhimit të Krizave”, Dukagjini, Pejë, 2012
6. Alan COLLINS: “Studime bashkëkohore të sigurisë”, Oxfrord press universit, Tiranë,2012
7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
8. Ligji i procedurës administrative të administratës tatimore
9. Ligji mbi doganat e Kosovës

3.3 Eseu

Ç’është eseja dhe çka duhet të përmbajë ?

Eseja është një formë e shkrimit ku shprehen qëndrimet dhe botëshikimet personale për ndonjë çështje nga jeta, morali, shkenca, arti, politika etj.

Eseja është formë e shkrimit që kërkon planifikim dhe përkushtim nga ana e studentit. Për të përgatitur një ese, studenti duhet të jetë shumë i vëmendshëm gjatë leximit, të analizoj, krahasoj dhe kritikoj temën e shtjelluar. Me anë të një eseje, studentët inkurajohen të analizojnë dhe shtjellojnë hollësisht temën e caktuar.

Një ese mund të ketë qëllime të ndryshme. Eseja mund të jetë e natyrës përshkruese, argumentuese ose shpjeguese. Në disa ese mund t’ju kërkohej shpjegimi i ndonjë koncepti, ndërsa në disa tjera krahasimi/dallimi ndërmjet koncepteve (teorive) të ndryshme. Përkundër qëllimeve të ndryshme të esesë, struktura bazike e saj mbetet e njëjtë.

Struktura e një eseje duhet të jetë e organizuar mirë. Për të qenë përmbajtja e saktë, struktura e saj duhet të jetë koherente. Pasi që të përcaktoni temën e esesë, ju duhet t’i identifikoni idetë kryesore dhe ti mbështetni me informata të hollësishme. Struktura e një eseje përbëhet nga tri pjesë dhe shkruhet në formë të paragrafëve:

- a) **Hyrja**- Në këtë pjesë, ju duhet të adresoni idetë/temat kryesore të esesë. Këtu ju duhet të ofroni një përmbledhje të ideve kryesore që do të shtjellohen më hollësisht në pjesën e dytë të esesë. Ju duhet të shpjegoni se si do ti zhvilloni idetë dhe argumentet tuaja.
- b) **Trupi** - Në këtë pjesë, ju duhet të shtjelloni temën e përzgjedhur. Këtë duhet ta bëni duke ofruar argumente të hollësishme bazuar në fakte. Argumentet duhet të jenë të pikëpamjeve të ndryshme rreth një çështje/teme të caktuar. Po ashtu, këtu ju ofroni edhe mendimin tuaj personal rreth temës/argumenteve përkatëse.
- c) **Përfundimi**- Në këtë pjesë, eseja mund të shtjellohet në forma të ndryshme. Ajo, mund të jetë një përmbledhje e asaj që është shkruar. Po ashtu, ju mund ta paraqitni edhe në formë të diskutimit se pse tema e shtjelluar është e rëndësishme. Nuk duhet të ofroni informata të reja në këtë pjesë të esesë.

Nga ju kërkohet të shkruani një ese analitike - (kur studenti duhet bëjë një interpretim logjik të temës që ka zgjedhur).

4. Pjesa e II-të - Njohuri nga fusha e drejtësisë

Në testimin e njohurive nga fusha e drejtësisë janë paraparë 100 pyetje parapërgatitore. Njohuritë nga fusha e drejtësisë janë të ndara në dy fusha të testimit të njohurive. Fusha e parë e testimit të njohurive përfshinë njohuritë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ku janë paraparë 50 pyetje parapërgatitore, ndërsa fusha e dytë e testimit të njohurive përfshin njohuritë nga lënda “Fillet e së drejtës”, që përbën lëndën bosht në hyrje apo baza të së drejtës, ku edhe këtu janë paraparë 50 pyetje parapërgatitore.

4.1 Njohuri nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Me anë të pyetjeve parapërgatitore nga Kushtetuta e Kosovës kandidati duhet të arrijë ti zotërojë njohuri të mirë për përmbajtjen e dokumentit më të rëndësishëm juridik të Republikës së Kosovës. Në mënyrë të veçantë duhet të arrijë të kuptojë dispozitat themelore të saj, liritë dhe të drejtat e qytetarëve që garantohen, rregullimin institucional të Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, sistemin e drejtësisë, sektorin e sigurisë dhe rregullimin dhe funksionimin kushtetutës të disa prej institucioneve të pavarura.

4.2. Pyetje orientuese:

- 1) Si përkufizohet shteti i Kosovës sipas Kushtetutës së Kosovës? (Neni 1)
- 2) Sipas Kushtetutës, si rregullohet sovraniteti i Kosovës? (Neni 2)
- 3) Si rregullohet forma e qeverisjes dhe ndarja e pushtetit? (Neni 3)
- 4) Si rregullohet përdorimi i gjuhëve dhe simboleve në Kosovë? (Neni 5 dhe 6)
- 5) Si rregullohet epërsia e kushtetutës në raport me aktet e tjera? (Neni 16)
- 6) Si janë të rregulluara marrëveshjet ndërkombëtare, ratifikimi, zbatimi i tyre dhe bartja e sovranitetit shtetëror? (Neni 17, 18, 19, 20)
- 7) Si janë të rregulluara parimet e përgjithshme për liritë dhe të drejtat themelore? (Neni 21)
- 8) Cilat marrëveshje apo instrumente ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë? (Neni 22)
- 9) Si rregullohen të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë këtu secilën të drejtë dhe liri veç e veç? (Neni 23 deri nën 52)
- 10) Ne harmoni me cilat vendime gjyqësore bëhet interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut? (Neni 53)
- 11) Si është e rregulluar kufizimi i të lirive dhe të drejtave themelore? (Neni 55)
- 12) Si janë të rregulluara të drejtat dhe liritë themelore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme? (Neni 56)
- 13) Cilat janë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, sipas Kushtetutës së Kosovës? (Neni 57 - 62)?

- 14) Cilat janë përgjegjësit e shtetit të Kosovës në raportet me pjesëtarët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë? (Neni 58)
- 15) Cilat janë parimet e përgjithshme dhe struktura dhe kompetencat e Kuvendit të Kosovës? (Neni 63, 64 dhe 65)
- 16) Si janë të rregulluara zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, mandati i deputetëve dhe si bëhet zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit? (Neni 66 dhe 67)
- 17) Si rregullohet çështja e mandatit të deputetit dhe kur e ka të pamundur të kandidohet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës? (Neni 70 dhe 73)
- 18) Si është i rregulluar imuniteti i deputetëve? (Neni 75)
- 19) Si është e rregulluar puna e komisioneve parlamentare? (Neni 77 dhe 78)
- 20) Si është e rregulluar nisma legjislative dhe miratimi i ligjeve? (Neni 79 dhe 80)
- 21) Çka përfshihet dhe si rregullohet legjislacioni me interes vital? (Neni 81)
- 22) Si është e rregulluar shpërndarja e Kuvendit të Kosovës?
- 23) Çka përfaqëson Presidenti i Republikës së Kosovës? (Neni 83)
- 24) Cilat janë kompetencat e Presidentit të Kosovës? (Neni 84)
- 25) Si është e rregulluar zgjedhja e Presidentit të Kosovës? (Neni 86)
- 26) Si është e rregulluar çështja e mandatit dhe betimit të Presidentit të Kosovës? (Neni 87) 27) Si është e rregulluar çështja e ushtrimit të ndonjë funksioni tjetër publik dhe çështja e imunitetit të Presidentit të Kosovës? (Neni 88 dhe 89)
- 28) Si janë të rregulluara rastet e mungesës së përkohshme të Presidentit të Kosovës? (Neni 90)
- 29) Si është e rregulluar procedura e shkarkimit të Presidentit të Kosovës? (Neni 91) 30) Si janë të rregulluara parimet e përgjithshme të Qeverisë së Kosovës? (Neni 92) 31) Cilat janë kompetencat e qeverisë dhe kryeministrit të Kosovës? (Neni 93 dhe 94) 32) Cilat janë procedurat e zgjedhjes së Qeverisë? (Neni 95)
- 33) Si është i rregulluar përfaqësimi i komuniteteve në Qeverinë e Kosovës? (Neni 96)
- 34) Si është e rregulluar përgjegjësia e Qeverisë dhe e krerëve të saj? (Neni 97)
- 35) Si është i rregulluar imuniteti i anëtarëve të Qeverisë? (Neni 98)
- 36) Si është i rregulluar mocioni i votëbesimit ndaj Qeverisë? (Neni 100)
- 37) Si janë të rregulluara parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor? (Neni 102)
- 38) Si është i rregulluar organizimi dhe juridiksioni i gjykatave? (Neni 103)
- 39) Si janë të rregulluara parimet e përgjithshme të Gjykatës Kushtetuese? (Neni 112)
- 40) Si është i rregulluar juridiksioni dhe palët e autorizuara pranë Gjykatës Kushtetuese? (Neni 113)
- 41) Si është i rregulluar efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese? (Neni 116)
- 42) Si është i rregulluar organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë? (Neni 124)
- 43) Si është i rregulluar institucioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës? (Neni 126)
- 44) Si është i rregulluar institucioni i Policisë së Kosovës? (128)
- 45) Si është e rregulluar gjendja e jashtëzakonshme? (Neni 131)
- 46) Cili është roli dhe cilat janë kompetencat e Avokatit të Popullit? (Neni 132)

- 47) Si është e rregulluar puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve? (Neni 139) 48) Si është e rregulluar amandamentimi i Kushtetutës së Kosovës? (Neni 144) 49) Si është e rregulluar çështja e shtetësisë së Kosovës? (Neni 155)
- 50) Kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Kosovës?

4.3 Literatura:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008 (**literaturë bazë**)
2. Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Arsim Bajrami, Prishtinë, 2011(**literaturë e rekomanduar**)

4.4 Njohuri nga Lënda: Fillet e së Drejtës

Me anë të pyetjeve parapërgatitore nga lënda: “Fillet e së drejtës”, kandidati duhet të arrijë ti zotërojë njohuritë themelore lidhur me shtetin dhe të drejtën, si dhe raportet në mes tyre; trajtat e shteteve; konceptin e normës juridike, llojet dhe strukturën e sajë; esencën e sundimit të së drejtës dhe rëndësinë e rendit juridik funksional; rëndësinë e mjeteve juridike dhe rëndësinë e garantimit të sigurisë juridike; burimet e së drejtës; aktet dhe llojet konkrete të akteve juridike; marrëdhëniet juridike, krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e tyre; zbatimin dhe mënyrat e zbatimit të së drejtës, si dhe me sistemin e së drejtës dhe llojet e tij.

4.5 Pyetje orientuese:

- 1) Çka kuptojmë me nocionin e shtetit?
- 2) Cilat janë elementet e shtetit dhe sqaro secilin element veç e veç?
- 3) Cili është nocioni i normës në përgjithësi?
- 4) Cilat janë llojet e normave?
- 5) Çka kuptojmë me nocionin e zakonit?
- 6) Çka kuptojmë me nocionin e normave të moralit?
- 7) Çka kuptojmë me nocionin e normave shoqërore të cilat i zbaton shteti?
- 8) Çka kuptojmë me nocionin e ndryshimeve evolutive dhe revolucionare?
- 9) Cilat janë llojet e ndryshimeve evolutive dhe çka kuptojmë me to?
- 10) Cilat janë ndryshimet revolucionare dhe cilat janë mënyrat e ushtrimit të tyre?
- 11) Çka kuptojmë me nocionin e organeve individuale dhe organeve kolegjiale?
- 12) Çka kuptojmë me nocionin e organeve të armatosura, civile, demokratike dhe ato burokratike?
- 13) Çka kuptojmë me nocionin e trajtave të shtetit dhe cilat janë llojet e tyre?
- 14) Çka kuptojmë me nocionin e trajtës së sundimit dhe çka paraqet shefi i shtetit, monarkia dhe republika?
- 15) Çka kuptojmë me nocionin e trajtës së regjimit politik dhe çka paraqet demokracia, autokracia dhe cilat janë llojet e tyre?
- 16) Çka kuptojmë me nocionin e trajtës së rregullimit shtetërorë? 17) Çka kuptojmë me nocionin e shtetit të përbërë?

- 18) Çka kuptojmë me nocionin e federatës dhe konfederatë? 19) Çka kuptojmë me nocionin e protektoratit?
- 20) Çka kuptojmë me nocionin e unionit real dhe unionit personal? 21) Çka kuptojmë me nocionin e trajtës së pushtetit shtetëror?
- 22) Çka kuptojmë me nocionin e sistemit presidencial, sistemit parlamentar dhe sistemit të përzier?
- 23) Çka kuptojmë me nocionin e rendit juridik?
- 24) Çka kuptojmë me nocionin e normës juridike dhe cilat janë llojet e normave? 25) Çka kuptojmë me nocionin e vlefshmërisë kohore të normave juridike?
- 26) Çka kuptojmë me nocionin e fuqisë prapavepruese të normave juridike?
- 27) Cila është struktura e normave juridike?
- 28) Çka kuptojmë me nocionin e dispozicionit të normës juridike dhe cilat janë llojet e dispozicioneve?
- 29) Çka kuptojmë me nocionin e sanksionit të normës juridike? 30) Çka kuptojmë me nocionin e marrëdhënieve juridike?
- 31) Cilat janë elementet e marrëdhënies juridike?
- 32) Cilët janë subjektet e së drejtës?
- 33) Çka kuptojmë me nocionin e personave fizikë dhe juridik, si subjekte të së drejtës? 34) Çka kuptojmë me nocionin e të drejtës subjektive dhe nocionin e kompetencës? 35) Çka kuptojmë me nocionin e obligimit juridik (detyrimi)?
- 36) Çka kuptojmë me nocionin e gjendjes juridike?
- 37) Çka kuptojmë me nocionin e lindjes, ndryshimit dhe shuarjes së marrëdhënieve juridike?
- 38) Çka kuptojmë me nocionin e fakteve juridike dhe me nocionin e parashkrimit? 39) Çka kuptojmë me nocionin e aktit juridik?
- 40) Cilat janë elementet e aktit juridik dhe si bëhet nxjerrja e aktit juridik? 41) Çka kuptojmë me nocionin e aktit të përgjithshëm juridik?
- 42) Çka kuptojmë me nocionin e kushtetutës dhe ligjit si akte të përgjithshme juridike? 43) Çka kuptojmë me nocionin e kodit (kodifikimit)?
- 44) Cilat janë aktet e përgjithshme shtetërore me fuqi nënligjore?
- 45) Çka kuptojmë me nocionin e dekretligjit, si akt të përgjithshëm me fuqi nënligjore?
- 46) Çka kuptojmë me nocionin e urdhëresës, rregullores, statutit, udhëzimit , dekretit dhe vendimit, si akte të përgjithshme me fuqi nënligjore?
- 47) Cilat janë aktet juridike që shërbejnë për plotësimin e zbrazëtirave juridike? 48) Çka kuptojmë me nocionin e aktit të veçantë juridik dhe cilat janë llojet e tij? 49) Çka kuptojmë me nocionin e ligjshmërisë dhe nocionin e mjeteve juridike? 50) Çka kuptojmë me nocionin e të drejtës pozitive?

4.6 Literatura:

1. Osman Ismaili: FILLET E SË DREJTËS, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2011 (literaturë bazë)

5. Pjesa e III-të - Njohuri logjike

Kjo pjesë përfshin pyetje që synojnë të testojnë kapacitetin intelektual për të arsyetuar dhe menduar në mënyre logjike të kandidatëve. Pyetje të logjikës kanë të bëjnë me njohuritë - gjegjësisht dijet dhe shkathhtësitë e përgjithshme të konceptet e matematikës bazë - elementare. Për dhënien e përgjigjeve të sakta në detyra nga kjo lëmi aplikative, përveç koncepteve të matematikës pastaj përdorimit të operacioneve themelore aritmetike hynë në përdorim dhe zbatueshmëri edhe shkathhtësia logjike e të menduarit për zgjidhjen e detyrave konkrete. Zgjidhja e saktë e detyrës është e dhënë në njërin nga opsionet e paraqitura në test nën a, b, c, d. Kjo do të jetë ndihmesë e veçantë sepse në njërin nga opsionet e paraqitura është e dhënë zgjidhja e sakte e detyrës, Nga studenti kërkohet vetëm aplikimi i njohurive nga matematika bazë i kombinuar me shkathhtësitë logjike për dhënien e përgjigjes së sakte. Janë grupi i dytë i detyrave të logjikës - numerike, por në këtë rast për dhënien e përgjigjes së saktë, vjen në shprehje aplikimi i logjikës numerike, Detyrat për zgjidhje paraqiten përmes serive të dhëna numerike. Seritë e dhëna numerike në detyrën konkrete duhet të përcillen me kujdes, ashtu që ndryshimi i paraqitur në mes të numrave duhet shikuar sipas shkallës së drejtimit të ndryshimit që paraqitet ndërmjet numrave. Me fjalë të tjera të konstatohet nëse numrat rriten apo zvogëlohen në mes veti, si dhe konkretisht me sa rriten, dhe zvogëlohen numrat në mes veti.